

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Protestat në Tiranë, Rama për gazetën gjermane: Jam më i mirë kur sfidohem! Koha do ta tregojë - Euro news Albania
ADRESA	https://euronews.al/protestat-ne-tirane-rama-per-gazeten-gjermane-jam-me-i-mire-kur-sfidohem-e-ardhmja-do-ta-deshmoje/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 17:59:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 17:59:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5286fb75666eaa99163b86e6160a0b54ec98033a330a6d0780b82818b5c111be
TEKSTI	3b524ca5504fceb0aaa0f1ed11db9625280c991cc89567ba8e0adef054484152
PAMJA	4377087b4ff6c72ca6072d443517f99c31b7d840d485c9499a387b8dd2b1293f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5ee81b501105197f014d05590df730a23b7b01999f234bb6202b32b0fb45fe52
E MËPARSHMJA	f69e121a304a6bcde4e4eed8cf6d61b344706282ef66cc57969cad8a4100d179
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5ee81b501105197f014d05590df730a23b7b01999f234bb6202b32b0fb45fe52>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Lufta në Iran OKB Edi Rama Protesta në Tiranë

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Protestat në Tiranë, Rama për gazetën gjermane: Jam më i mirë kur sfidohem! Koha do ta tregojë

20 Shtator 2026 | 19:59

Kryeministri Edi Rama dh protesta qytetare në Tiranë kanë qenë në fokus të gazetës gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung". Në artikullin e medias gjermane shkruhet se Rama i ka cilësuar protestat si një sfidë për qeverinë. Në artikull theksohet se kryeministri Rama i konsideron protestat një provë besimi për qeverinë e tij dhe një mundësi për reflektim.

"Për mua është një sfidë. Por kjo është diçka e mirë. Gjatë gjithë jetës sime politike, gjërat nuk kanë shkuar kurrë vërtet mirë kur nuk jam sfiduar. Zakonisht jam më i mirë kur sfidohem. A do të jem më i mirë edhe këtë herë? Shpresoj. Nuk e di. Koha do ta tregojë. E ardhmja do ta dëshmojë", citohet Kryeministri Rama.

Sipas kryeministrit, protestat janë një shenjë pozitive kur qytetarët dalin në rrugë për biodiversitetin, mbrojtjen e mjedisit dhe çështje të tjera me interes publik.

Lidhur me projektet në Zvërnec dhe ishullin e Sazanit, Rama hodhi sërish poshtë akuzat për "shitje" të Shqipërisë teksa theksoi se Sazani vazhdon të jetë pronë e shtetit shqiptar.

Sipas tij, ende nuk është finalizuar një marrëveshje për zhvillimin e ish-zonës ushtarake të Sazanit nga investitorë privatë.

"Rama këmbëngul se promovimi i investimeve të huaja direkte, veçanërisht në sektorin e turizmit, nuk e bën atë një vegël të Trumpit. Sipas tij, perspektiva e investimeve me vlerë mbi katër miliardë euro në projektet e planifikuara nga Jared Kushner dhe partnerët e tij nuk është diçka që një kryeministër mund ta refuzojë thjesht, nëse mendon për interesin e vendit", shkruhet në artikull.

Lidhur me ndikimin e protestave në turizëm, artikulli vëren se ato sollën një ngadalësim të lehtë të rritjes së sektorit, por situata duket se është kapërcyer. Shqipëria pritet të regjistrojë këtë vit 14 deri në 15 milionë vizitorë, krahasuar me rreth 12.5 milionë një vit më parë.

Artikulli i plotë:

Prej më shumë se njëqind ditësh ata mblidhen çdo mbrëmje. Rreth orës 19:00 njerëzit grumbullohen në zemër të Tiranës dhe ecin përgjatë Bulevardit "Dëshmorët e Kombit". Afërsisht në gjysmën e rrugës ndodhet zyra e kryeministrit, për të cilin kërkojnë

LAJMI I FUNDIT

19:39 AFD kryeson sërish. "Katastrofë" për CDU-në në zgjedhjet lokale, Merz: Nuk largohem

19:35 Dita e 113-të e protestës, qytetarët mblidhen para Kryeministrit (VIDEO)

19:33 Vedat Muriqi shkëlqen me katër gola, Fenerbahçe mposht 8:0 Eyupsporin

19:35 Haradinaj ngjitet në majën e SHPIRNDALËS
ARTIKULLIN
Rupës, valëvit flamurin e UÇK-së

19:12 Zhdukja e Madeleine, i dyshuari kryesor flet për herë të parë: Po shisja drogë! Policia më ndaloj 3 herë

18:57 Kryeministri i Katarit: Siguria rajonale ka nevojë për respektim të sovranitetit, jo për cikle përshkallëzimi

TESTIM

dorëheqjen.

Pikërisht aty protesta bëhet më e zhurmshme. Hera herës, para godinës ka përplasje me efektivet e policisë dhe arrestime, por shumicën e kohës situata mbetet paqësore.

Kështu ndodh mbrëmje pas mbrëmjeje. Gjatë ditëve të javës, protestuesit janë dukshëm më të shumtë në numër sesa në fundjavë, kohë kur edhe protestuesit më këmbëngulës zgjedhin ndonjëherë detin, në vend që të qëndrojnë gjithmonë në rrugët e Tiranës. Këto të fundit mbushen nga të rinjtë që dalin për të festuar. Ata festojnë të paktën po aq zhurmshëm dhe gjatë sa protestuesit demonstrojnë. Janë dy botë paralele që duket sikur nuk priten me njëra-tjetrën.

I vetëshpalluri "Revolucion i Flamingove" në Shqipëri, deri tani nuk është shndërruar në një lëvizje masive. Megjithatë, ka treguar këmbëngulje. Të njëjtën gjë po bën edhe kreu i qeverisë Edi Rama. Ai është në pushtet që prej vitit 2013 dhe është i vendosur të qëndrojë deri në fund të legjislaturës në vitin 2029.

Cila palë do t'ia dalë të rezistojë deri në fund?

Protestat në kryeqytetin shqiptar nisën në fund të majit. Shkak u bë ndërhyrja e ashpër e punonjësve të një kompanie private sigurie pranë një gardhi kantieri. Gardhi ishte ngritur në skajin verior të gadishullit të Zvërnecit, ku do të nisin punimet paraprake për një projekt turistik luksoz. Kundër projektit, që po shtyhet përpara nga kompania e investimeve Affinity Partners e Jared Kushnerit, dhëndrit të Donald Trumpit, kishin protestuar në vend disa qindra persona.

Gjatë protestës pati përplasje pranë gardhit. Rojet tërhoqën zvarrë disa protestues mbi zhavorr për t'i larguar nga gardhi i kantierit. Pamjet e regjistruara me celular të ndërhyrjes, ku askush nuk u lëndua rëndë, u bënë virale.

Por si mundi një incident relativisht i parëndësishëm të shndërrohej në një lëvizje proteste kombëtare, që madje e quan veten revolucion?

Kjo lidhet edhe me flamingot, të cilët lëvizja i ka zgjedhur si simbolin simpatik të ndryshimit që synon. Ambientalistët druhen se kolonitë e flamingove rozë dhe të shpendëve të tjerë shtegtarë mund të rrezikohen nga bumi turistik në jug të Shqipërisë – veçanërisht nga resortet luksoze të planifikuara nga investorët arabë dhe nga Katari të lidhur me grupin e Kushnerit. Habitati i flamingos rozë është pikërisht Laguna e Nartës, një zonë e mbrojtur pranë Zvërnecit.

'Lëvizja e Flamingove' e akuzon qeverinë për korrupsion dhe kërkon zgjerimin e zonave të mbrojtura, fundin e favorizimit të investorëve të mëdhenj dhe zgjedhje të reja demokratike.

Fillimisht Rama, i cili drejton Partinë Socialiste që prej vitit 2005 dhe qeverinë që prej vitit 2013, u përpoq t'i linte protestat të vetëkonsumoheshin. Protestuesve u tha se nuk mund të shfaqeshin një ditë të bukur dhe të rrëzonin nga detyra kryeministrin e zgjedhur dhe qeverinë e tij.

"Kështu nuk funksionon. Duhet të prisni deri në zgjedhjet e ardhshme." Ishte një argument i vështirë për t'u hedhur poshtë. Në zgjedhjet parlamentare të majit 2025, Rama dhe socialistët e tij kishin fituar më shumë se 52 % të votave. Ishte fitorja e katërt radhazi e socialistëve në zgjedhje, ndërsa Rama dhe partia e tij kishin rritur vazhdimisht përqindjen e votave.

Megjithatë, pikërisht pasi kishte marrë mandatin më të fortë nga zgjedhësit, Rama u përball papritur me kërcënimin më serioz ndaj pushtetit të tij. Pak më pak se dy muaj pas nisjes së protestave, ai ndryshoi taktikë. Në vend që t'u tregonte më tej "grushtin" protestuesve nëpërmjet retorikës, tani po përpiqet t'u rrahë shpatullat. Protestat, thotë tani, janë shenjë e vitalitetit dhe stabilitetit të demokracisë shqiptare. Ai bën dallimin mes atyre që paraqesin kërkesa legjitime dhe duhen dëgjuar, dhe atyre që, sipas tij, po përdoren nga kundërshtarët e tij brenda dhe jashtë vendit për qëllime politike.

Në një fjalim të fortë para grupit parlamentar të socialistëve në fund të korrikut, Rama paraqiti strategjinë e re të qeverisë. Ai foli për një krizë të thellë të besimit publik. Përpara figurave të partisë së tij, të mësuara me fitore elektorale, Rama u ankua për "paradoksin e suksesit": sa më shumë zhvillohet dhe begatohet një shoqëri, aq më pak ajo gjykon atë që është arritur dhe funksionon, dhe aq më shumë përqendrohet te ajo që mungon dhe nuk funksionon.

Shoqëritë e varfra, tha ai, janë më tolerante ndaj mangësive, sepse mbizotëron mendësia se "mund të ishte edhe më keq". Shqipëria, sipas Ramës, e ka lënë pas këtë fazë dhe ka hyrë në një tjetër, ku mbizotëron ideja se "mund të ishte edhe më mirë".

Prandaj, sipas tij, tani nevojitet një "shtet përkujdesës", që të dëgjojë dhe marrë seriozisht përvojat e qytetarëve, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve dhe investimeve dhe në këtë mënyrë të forcojë besimin e qytetarëve te shteti.

Fjalimi i Ramës u prit, pozitivisht nga deputetët dhe funksionarët e Partisë Socialiste. Përfaqësuesit e Lëvizjes së Flamingove e hodhën poshtë si një manovër retorike për të shmangur vëmendjen nga problemet themelore: korrupsioni, mungesa e transparencës dhe shkatërrimi i mjedisit.

Sali Berisha, kreu i opozitës konservatore nga Partia Demokratike, hodhi dyshimin se Rama kishte përdorur inteligjencën artificiale për të hartuar dokumentin 40-faqësh, të cilin e

cilësoi pa përmbajtje dhe të shkruar keq.

Vetë Rama nuk të jep përshtypjen se ndihet i vënë në mbrojtje nga “Revolucioni i Flamingove”. Ai të pret në zyrën e tij në Kryeministri. Atletet e bardha i ka poshtë tavolinës. Me pantallonat e gjera të zeza, pulovrën e zezë dhe me çorape të zeza. Në një varëse rrobash varen fanella basketbolli që ish-lojtari i kombëtares shqiptare i ka marrë dhuratë. Dollapët dhe raftet janë të mbushura me objekte të ndryshme arti.

Rama nuk beson se vendi ndodhet në një pikë kthese, e aq më pak në një pikë thyerjeje. “Por pa dyshim është një provë besimi.” Ai thotë se përpiqet ta shohë gotën njëkohësisht gjysmë plot dhe gjysmë bosh.

“Nëse dikush tjetër e sheh gotën gjysmë bosh, është në rregull. Ai sheh më pak atë që kemi arritur dhe kërkon më shumë. Ndërsa ai që e sheh gotën gjysmë plot, sheh pikërisht atë që kemi arritur.”

Në parim, sipas tij, është shenjë pozitive kur njerëzit dalin në rrugë – për biodiversitetin, për mbrojtjen e mjedisit dhe për çështje të tjera.

“Për mua është një sfidë. Por kjo është diçka e mirë. Gjatë gjithë jetës sime politike gjërat nuk kanë shkuar kurrë vërtet mirë kur nuk jam sfiduar. Zakonisht jam më i mirë kur sfidohem. A do të jem më i mirë edhe këtë herë? Shpresoj. Nuk e di. Koha do ta tregojë. E ardhmja do ta dëshmojë.”

Sa i përket shkakut të drejtpërdrejtë të protestave në rivierën shqiptare, Rama kujton se kontakti i parë me Jared Kushner dhe Ivanka Trump për një investim të mundshëm në Zvërnec dhe në ishullin e Sazanit kishte ndodhur në një kohë kur Donald Trump nuk ishte ende sërish president.

“Jeta e Trumpit në atë kohë lëkundej mes burgut dhe Shtëpisë së Bardhë.”

Rama këmbëngul se fakti që, si kryeministër shqiptar, promovon investimet e huaja direkte në vendin e tij, veçanërisht në sektorin kyç të turizmit, nuk e bën atë një vegël të Trumpit.

Dhe perspektiva e më shumë se katër miliardë eurove investime në projektet e planifikuara nga Kushner dhe partnerët e tij, thotë Rama, nuk është diçka që ai si kryeministër mund ta refuzojë thjesht, nëse mendon për interesin e vendit.

Megjithatë, sipas tij, nuk mund të flitet për një “shitje” të Shqipërisë. Ishulli i Sazanit vazhdon të jetë pronë e shtetit shqiptar dhe do të mbetet i tillë. Ende nuk është arritur asnjë marrëveshje për zhvillimin e mundshëm të ish-zonës së mbyllur ushtarake nga investitorë privatë në një resort luksoz.

Në qershor, protestat sollën një ngadalësim të vogël në rritjen e turizmit shqiptar. Tani kjo duket se është kapërcyer. Këtë vit Shqipëria pritet të regjistrojë 14 deri në 15 milionë vizitorë, krahasuar me rreth 12.5 milionë një vit më parë.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

Dita e 113-të e protestës, qytetarët mblidhen para Kryeministrit (VIDEO)

Edhe këtë të diele qytetarë dhe aktivistë të shumtë kanë dalë në protestën e radhës e cila hyri në ditën e saj të 113-të. Si...

19:35 | 20/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Rama njofton takimin me shqiptarët në Michigan

Kryeministri Edi Rama përmes një postimi në “Facebook” ka njoftuar se këtë të diele do të zhvillohet një takim me shqiptarët në Michigan. Ky takim...

17:02 | 20/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

Vrasja e 44-vjeçarit, Hita mbërrin në Sarandë. Zhvillon mbledhje urgjente (VIDEO)

Një ngjarje e rëndë kriminale ka tronditur qytetin e Sarandës paraditen e kësaj të diele, ku 44-vjeçari Artan Murtaj është vrarë me armë zjarri në...

16:53 | 20/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.